



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE ME JASHTË

Tiranë, 24/02/2026

NJOFTIM

**PËR THIRRJEN E MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË GJYQ TARËVE TË
REPUBLIKËS PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Në zbatim të nenit 247 të ligjit nr. 115/2016 “*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*”, Kryetari i Gjykatës së Lartë Z. Sokol Sadushi, thërret Mbledhjen e Përgjithshme të gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, në **datën 13 Mars, ora 10:00**. Mbledhja do t’i zhvillojë punimet në mjediset e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në vijim të njoftimit të datës 02/02/2026 lidhur me hapjen e garës për paraqitjen e kandidaturave nga radhët e gjyqtarëve për anëtar të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, kanë paraqitur kandidaturat për këtë pozicion gjyqtarët si vijon:

- 1) **Erjon Bani** – gjyqtar i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- 2) **Gerd Hoxha** – gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Nga procesi i verifikimit rezultoi se të dy kandidatët i plotësonin kushtet ligjore për t’u zgjedhur anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

Agjenda e punimeve të mbledhjes, do të jetë si vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E GJYQTARËVE

Zgjedhja e anëtarit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës

13 MARS 2026

A G J E N D A

- 09.00 – 10.00 Regjistrimi i pjesëmarrësve
- 10.00 – 10.10 Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, Z. Sokol Sadushi
- 10.10 – 10.20 Prezantimi i kandidatëve për anëtar të Këshillit Drejtues të Shkollës së
Magjistraturës (5 minuta)
- 10.20 – 10.25 Ngritja e Komisionit të Votimit
- 10.25 – në vijim Zhvillimi i votimit
- Shpallja e rezultatit të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Drejtues të
Shkollës së Magjistraturës